

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MARKEV” SH.P.K**

Sot, në Tiranë më datë **04 Gusht 2023** në përshtatje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 (i ndryshuar)“Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit”,

Z. Gerald Alia, i biri i Qemal dhe Shpresa, i datëlindjes 07/11/1998, lindur dhe banues në Tiranë me adresë Rruga “Myslym Keta”, Njësia Administrative nr.4, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me numër personal J81107042], themelon në cilësinë e adminsitrorit dhe ortakut të vetëm, Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “MARKEV” sh.p.k., me përmbajtjen si më poshtë vijon:

**NENI 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESI**

1.1.Sot, më *04 Gusht 2023* unë themeluesi i mësipërm kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin tregtar “**MARKEV**” shpk.

**NENI 2
SELIA**

2.1.Selia e Shoqërisë “MARKEV” shpk është në adresën Rruga “Hoxha Tahsin”, pall. 109, nr.9, me sipërfaqe 20 m2, Tiranë shoqëria mund të hap degë ose zyra përfaqësimi si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë., në përshtatje me ligjet e vendeve ku ato do hapen.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

3.1.Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë “MARKEV” shpk është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimit të marrë nga Asambleja e Ortakëve.

**NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

4.1.Shoqëria do të ketë për objekt kryesor të veprimtarisë së saj:
4.1.1 Këmbim valuator.



- 4.1.2 Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave në emër dhe për llogari të një subjekti financiar joBankë.
- 4.1.3 Veprimtari e agjentit për transfertë parash në emër dhe për llogari të një subjekti financiar joBankë.

4.2. Shoqëria, për të realizuar objektivat e saj, mund të ndërmarrë e të zhvillojë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që siguron të ardhura dhe fitime të ligjshme.

4.3. Objekti i Shoqërisë mund të zgjerohet apo zvogëlohet në varësi të interesave të shoqërisë dhe në bazë të vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakëve.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.500.000 lekë (dy milion e pesëqind mijë lekë) dhe zotërohet tërësisht nga ortaku themelues Gerald Alia, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 2.500.000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 6 DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

6.1. Shoqëria "MARKEV" shpk deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut dhe Akt Themelimi dhe ato të legjislacionit shqiptar në fuqi, veçanërisht dispozitat urdhëruese e normative të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

6.2. Shoqëria fiton personalitetin juridik që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit, si person juridik, ndërsa e ushtron aktivitetin ekonomik me regjistrimin si subjekt në Zyrën e Tatim-Taksave.

6.3. Emërtimi i shoqërisë, kapitali themeltar dhe emri i Administratorit të saj duhet të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra prej shoqërisë dhe që u drejtohen të tretëve.

NENI 7

7.1. Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen Shoqëria "MARKEV" shpk. Ajo ka llogari të saj në lekë dhe valute në bankat e Shqipërisë.

NENI 8

8.1. Organet kryesore drejtuese të shoqërisë:

- 8.1.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- 8.1.2. Administrator.

NENI 9 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE



9.1.Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi sovran i shoqërisë, përbërhet nga ortaku i vetëm i saj.

9.2.Asambleja miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

9.3.Vendimet e marra nga Asambleja në përputhje me Statutin dhe Akthin e Themelimit, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, janë të detyrueshme për ortakun e Shoqërisë.

9.4.Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimin e statutit;
- c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) Perfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

9.5.Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për organizimin dhe prishjen e shoqërisë.

9.6.Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar rë drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 10

MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE

10.1.Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë drejtuar ortakëve të shoqërisë. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin

e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

10.2.Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 10.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 11 KUORUMI

11.1.Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

11.2.Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.

11.3.Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 12 MARRJA E VENDIMEVE

12.1.Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

12.2.Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesmarrës për çështje të tjera si:

- a) Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve;
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;

12.3.Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 13 ADMINISTRIMI



13.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë, të cilët duhet të jenë detyrimisht ortakë të saj. Afati i emërimit të administratorit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në QKB.

13.2. Administratori i parë i Shoqërisë është Z. **Geraldi Alia**, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjeçare.

NENI 14 **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE**

14.1. Administratorët detyrohen të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

14.2. Administratorët detyrohen të përfaqësojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar;

14.3. Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë;

14.4. Të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

14.5. Të krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarrvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

14.6. Të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

14.7. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.

NENI 15 **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

Ortakët kanë këto të drejta kryesore:

15.1. të administrojnë aktivitetin e shoqërisë në përputhje me Statutin dhe Aktin Themelues;

15.2. të marrin pjesë në fitimet e çfarëdo forme a sasi të aktivitetit të Shoqërisë, të parashikuara nga Akti Themelues e Statuti i Shoqërisë;

15.3. të marrin në çdo moment dokumenta, si raporti i administrimit, inventare e llogari vjetore, për tre vitet e fundit financiar;

15.4. të tërhiqet nga Shoqëria, duke ia ofruar kuotën e vet me përparësi ortakëve të tjerë të shoqërisë. Në mungesë të ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë, kuota mund t'ju kalojë të tretëve, sipas kushteve e afateve të parashikuara në Statutin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë.

NENI 16

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

16.1. të depozitojnë kuotën e tyre fillestare të nevojshme si dhe ato suplementare në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit;



- 16.2.të marrin pjesë në administrimin e Shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë;
- 16.3. t'i japin Shoqërisë të dhënat e nevojshme për arritjen e të gjitha objektivave të qënësishme për aktivitetin e saj;
- 16.4.të përmbushin të gjitha detyrat për realizimin e objektivave dhe funksioneve të shoqërisë.

NENI 17

LARGIMI I ORTAKUT

17.1.Ky statut dhe akt themelimi nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për tu larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun në bazë të dispozitave përkatëse të legjislacionit tregtar në fuqi.

NENI 18

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

18.1.Përfaqësimi i Shoqërisë "MARKEV" shpk i përket administratorit të saj Z.Geraldi Alia dhe/ose personave të autorizuar prej tij.

NENI 19

KONTROLLI I BRENDSHËM

19.1.Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekspert kontabël të autorizuar, i cili zgjidhet çdo 5 vjet nga Administratori i Shoqërisë sipas dispozitave të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 20

BILANCI DHE TË ARDHURAT

- 20.1.Viti financiar i Shoqërisë mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti.
- 20.2.Në mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqërisë bën inventarin dhe llogaritë vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për administrimin.
- 20.3.Shoqëria nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur, po të jetë e nevojshme humbjet e vitit të mëparshëm, lë mënjanë një shumë me vlerë të paktën 1/20 e tij, e cila destinohet për formimin e një fondi reserve të quajtur "rezervë e domosdoshme".
- 20.4.Të ardhurat neto pas shlyerjes së detyrimeve fiskale dhe atyre ndaj të tretëve ndahen midis ortakëve të Shoqërisë në përshtatje me kuotat e secilit në formimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 20.5.Fitimi që do të shpërndahet, përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën dhe nga ana tjetër, janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e mëparëshme.



NENI 21 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

21.1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë. dh) me vendim të gjykatës;

21.2. Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

21.3. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

21.4. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues

NENI 22 EKSPERTI KONTABËL

22.1. Ortakët caktojnë ekspertin kontabël. Ai mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e të gjitha llogarive të Shoqërisë.

22.2. Detyra e ekspertit kontabël kryet nga persona të autorizuar nga ligji për veprimtari të tilla.

NENI 23 MARRËDHËNIET E PUNËS

23.1. Marrëdhëniet e punës në Shoqërinë "MARKEV" shpik rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështje që nuk rregullohen me kontratë pune zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

23.2. Të punësuarit në Shoqëri përgjigjen sipas ligjit dhe sipas Statutit për moszbatimin e detyrave të caktuara si dhe për dëmet që ata i shkaktojnë Shoqërisë.

NENI 24 MOSMARRËVESHJET

24.1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti dhe akt themelimi, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nën juridiksionin e së cilit shtrihet aktiviteti i Shoqërisë.

NENI 25
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

25.1.Përsa nuk është shprehur në këtë statut dhe akt themelimi, shoqëria i referohet plotësisht nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, si dhe dispozitave të legjislacionit shiptar.

25.2.Çdo ndryshim e plotësim i Statutit të Shoqërisë nuk prek personalitetin juridik të Shoqërisë "MARKEV" shpk.

25.3.Ky statut dhe akt themelimi përpilohet në 4 kopje me përmbajtje të njëjta dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipë dhe pasi u miratua në parim dhe nen për nen nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë, u nënshkrua rregullisht nga ai dhe pa asnjë vërejtje.

ORTAKU I VETËM THEMELUES
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"MARKEV" SH.P.K

Z. GERALDI ALIA

Gerald Alia